



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. 111-35805 /2016
Kaçanik, 01.11.2016

Në bazë të nenit 5 pika(c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe në bazë të Vendimit nr.352/16 nga Inspektoriati i Punës Ferizaj, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, shpallë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

1. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „Emin Duraku” në Kaçanik:

1.1 Një mësimdhënës i lëndës Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, me kohë të caktuar (zëvendësim pushim i lehonisë).

1.2 Një mësimdhënës i lëndës Gjuhë Angleze në paralelet e ndara fizike: Llanishtë- Gjurgjedell.

1.3 Një mësimdhënës i lëndës Edukatë Muzikore, me kohë të caktuar (zëvendësim pushim i lehonisë).

2. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „Nazmi Osmani” Elezaj:

Një mësimdhënës i lëndës Gjuhë Angleze.

3. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „Dituria” Ivajë:

Një mësimdhënës i Mësimi Klasor dhe

Një Edukatore, me kohë të caktuar (zëvendësim pushim i lehonisë).

4. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët „7 Shtatori ” në Begracë:

Një mësimdhënës i lëndës Edukatë Fizike, me kohë të caktuar (zëvendësim pushim i lehonisë).

5. Shkolla e Mesme Profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” Kaçanik:

Një mësimdhënës i lëndës Matematikë me 18 orë.

Kushtet e Konkursit:

Për vendet e punës të shënuar më lartë, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it .Nr.06/2015 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Të drejtë aplikimi në konkurs kanë kandidatët e degës përkatëse.

Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin si në vijim:

- diploma e fakultetit përkatës, kopje e vërtetuar,
- ekstrakti i lindjes, dhe
- kopjen e letërnjoftimit.


Afati dhe mënyra aplikimit.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores-Zyra e Pranimit, kati përdhës.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik prej 02.11.2016 deri 16.11.2016.



Drejtori i drejtorisë
Enver Kamishi